

VENDIM
Nr. 764, datë 30.9.2020

PËR TRANSFERIMIN NË PRONËSI TË BASHKISË KOLONJË, PËR NJËSINË ADMINISTRATIVE QENDËR ERSEKË, TË PASURISË 685, ZONA KADASTRALE 3510

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3, shkronja “ç”, e 5, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Transferimin në pronësi të Bashkisë Kolonjë, për njësinë administrative Qendër Ersekë, të pasurisë 685, zona kadastrale 3510, sipas formularit gjithsej 1 (një) fletë dhe hartës kadastrale, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij, me qëllim për t'u përdorur në fushën e zhvillimit ekonomik.

2. Pasuria e përmendur në pikën 1, të këtij vendimi, i shtohet listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 247, datë 27.3.2013, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Ersekë, të Qarkut të Korçës”.

3. Ngarkohen Bashkia Kolonjë dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe

1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE (Per inventarizimin e pronave te vecanta)										
Bashkia Kolonje				Identifikoli: Muharem Tartari ,specialist DPKZHT (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)						
Fusha e perdorimit te Prones: Ne fushen e bujqesise				Supervizori: Marsela Kristo ,Drejtore DPKZHT (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)						
				Aprovi: Kryetari i Bashkise (emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)						
Nr. Rend.	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdonimit	Te dhena te tjera (Shenime te vecanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	3510 231-A-B-C-D	685	Zallishte	Zall i Starjes NJESIA ADMINISTRATIVE QENDER Bashkia Kolonje	1020711	0	zallishte	Bashkia Kolonje	Bashkia Kolonje	

HARTE KADASTRALE (Fragment)

BASHKIA KOLONJE KRYETAR Erion ISAI Pergjegjës: Specialist Ing. Topograf: inxh. Muhârem TARRARI nr. lq. K. 1601/1	A. IDENTIFIKIM
	ZONA KADASTRALE: 3510 N
	INDEKSI I HARTËS: K-34-126-
	ADRESA E PASURISË: Bashk
	Rr _____ P/G
B. KUFIZIMET	
VERI: _____	
JUG: _____	
LINDJE: _____	
PERENDIM: _____	
Data: 5.6.2020	

Projektimi: KORNIZA REFERUESE GJEODEZIKE SHQIPTAR
Sistemi koordinativ: [KRGJSH]

